

Pyetjet më të shpeshta (Albanian)

Rreth programit

1. Çfarë është Fair Fares NYC?4
2. A po kalon Fair Fares NYC (FFNYC) nga MetroCard në një kartë One Metro New York (OMNY) Card?4
3. A duhet ta kaloj zbritjen FFNYC në OMNY?4
4. A mund të transferoj para nga MetroCard në kartën OMNY?5
5. Si funksionon zbritja Fair Fares NYC?5

Kriteret e kualifikueshmërisë

6. Kush kualifikohet për të marrë pjesë?6
7. Jam duke marrë pjesë aktualisht në programin MTA Reduced-Fare. A kualifikohem për zbritjen Fair Fares NYC?6
8. A ndikon statusi im i imigracionit në aftësinë time për të marrë pjesë në Fair Fares NYC?6

Aplikimi për zbritjen Fair Fares NYC dhe marrja e saj

9. Si mund të aplikoj për një zbritje Fair Fares NYC?6
10. Si ta zbuloj nëse aplikimi im është miratuar?7
11. Për sa kohë mund të marr pjesë në programin Fair Fares NYC?7
12. Kur do të pajisem me kartën Fair Fares NYC OMNY?7
13. Më është miratuar karta Fair Fares NYC OMNY Card por nuk më ka ardhur me postë. Çfarë duhet të bëj?7
14. Kam vështirësi me faqen e internetit nyc.gov/accessfairfares. Si mund të kërkoj ndihmë?7
15. Më duhet ndihmë për të plotësuar aplikimin e Fair Fares NYC. Kush mund të më ndihmojë?7
16. Unë e marr postën në një kuti postare. Si mund ta marr kartën Fair Fares OMNY?8
17. Si ta përditësoj adresën time postare?8
18. Më është refuzuar aplikimi për Fair Fares. Si mund të marr më shumë informacion?8

Si të dorëzoni dokumentet e aplikimit dhe pyetje të tjera të ngjashme

- 19. Çfarë dokumentesh do të më duhen për të verifikuar moshën, vendbanimin në qytetin e Nju-Jorkut dhe të ardhurat e mia?8
- 20. Si t'i dorëzoj dokumentet për aplikimin tim?8
- 21. U përpoqa t'i dorëzoja dokumentet, por nuk funksionoi. Si mund të kërkoj ndihmë?8
- 22. Si mund ta di nëse i keni marrë dokumentet e mia?9
- 23. A ka afat për dorëzimin e dokumenteve?9
- 24. Çfarë ndodh nëse nuk i dorëzoj dokumentet në kohë?9

Përdorimi i kartës suaj Fair Fares NYC OMNY Card

- 25. Ku mund ta gjej numrin e kartës Fair Fares OMNY Card?9
- 26. Çfarë është numri i llogarisë tranzit i kartës OMNY dhe ku mund ta gjej atë?9
- 27. A mund ta përdorë kartën time Fair Fares NYC OMNY Card (FFOC) një anëtar i familjes sime ose një miku im?9
- 28. A mund ta përdor kartën time Fair Fares OMNY Card (FFOC) në të gjitha sistemet e transportit publik të qytetit të Nju-Jorkut?10
- 29. Si të shtoj para në kartën time Fair Fares NYC OMNY Card (FFOC)?10
- 30. A e marr tarifën maksimale bashkë me kartën Fair Fares NYC OMNY Card (FFOC)?10
- 31. A duhet të krijoj një llogari OMNY?11
- 32. Çfarë duhet të bëj nëse më është tarifuar tarifa e plotë dhe jo tarifa e zbritur?11
- 33. Kë duhet të telefonoj nëse kam një pyetje rreth një tarifimi në kartën time OMNY (e ndryshme nga tarifa e plotë)?11

Humbja e kualifikueshmërisë

- 34. Kam marrë njoftimin se regjistrimi im po ndërpritet për shkak se nuk kualifikohem më. Mendoj se ka ndodhur një gabim. Me kë mund të flas?11
- 35. Sa kohë kam për të bërë kërkesë për rishikimin e përcaktimit të kualifikueshmërisë sime?12
- 36. Çfarë ndodh nëse marr njoftimin se zbritja Fair Fares NYC do të ndërpritet për shkak të keqpërdorimit ose të veprimtarisë së paautorizuar?12

Kartat e humbura ose të vjedhura

- 37. Sa herë mund ta zëvendësoj kartën time të humbur ose të vjedhur Fair Fares NYC OMNY?12
- 38. Si të veproj nëse karta FFNYC OMNY më ka humbur, më është vjedhur ose dëmtuar? ...12
- 39. Si ta kaloj gjendjen e mbetur në kartën time të re?13

Rinovimet

- 40. Sa shpesh duhet ta rinovoj regjistrimin tim në Fair Fares NYC?13**
- 41. Si mund ta rinovoj regjistrimin tim në Fair Fares NYC?13**
- 42. A do të njoftohem kur duhet të bëj rinovim?.....13**
- 43. A ka një afat për rinovimin?13**
- 44. Çfarë ndodh nëse nuk e arrij afatin e rinovimit?.....14**
- 45. Si mund ta di nëse kualifikohem ende për Fair Fares NYC?14**
- 46. Si ta përditësoj adresën time, ose çdo informacion tjetër që ka ndryshuar vitin e kaluar?.....14**
- 47. Po nëse adresa ime e re nuk është në qytetin e Nju-Jorkut?14**
- 48. Çfarë dokumentesh duhet të dorëzoj bashkë me aplikimin për rinovim?14**
- 49. A do të pajisem me një kartë të re Fair Fares NYC OMNY kur të bëj rinovimin?14**
- 50. A do të jem në gjendje të vazhdoj ta përdor zbritjen aktuale Fair Fares NYC pasi të miratohet aplikimi im për rinovim?.....15**

Kartat e skaduara

- 51. Si mund ta kuptoj se kur është afër skadencës karta ime Fair Fares NYC OMNY?15**
- 52. Çfarë ndodh nëse karta ime Fair Fares NYC OMNY do të skadojë në më pak se 30 ditë?15**
- 53. A mund të përdor një kartë Fair Fares OMNY të skaduar nëse ka ende para brenda?.....15**

Rreth programit

1. Çfarë është Fair Fares NYC?

Programi Fair Fares NYC është një program i qytetit që ndihmon banorët e Nju-Jorkut me të ardhura të ulëta që të menaxhojnë kostot e tyre të transportit. Duke përdorur Fair Fares NYC, banorët e kualifikueshëm të qytetit të Nju-Jorkut marrin një zbritje prej 50% për tarifat e metrosë dhe të autobusëve të kualifikueshëm, ose 50% zbritje për udhëtimet e Access-A-Ride Paratransit.

Kthehuni në krye

2. A po kalon Fair Fares NYC (FFNYC) nga MetroCard në një kartë One Metro New York (OMNY) Card?

Po. FFNYC nuk dërgon më karta Fair Fares MetroCard (FFM). Nëse keni një FFM, mund ta përdorni derisa të ndodhë një nga të mëposhtmet (cilado është më e hershme):

- a) karta skadon (data e skadimit ndodhet në pjesën e pasme të kartës suaj);
- b) karta nuk funksionon më;
- c) karta çaktivizohet; ose
- d) ju nuk jeni më i regjistruar në programin Fair Fares.

Ju do të pajiseni me kartën tuaj OMNY në një nga këto mënyra:

- Kur të rinovoni regjistrimin tuaj në FFNYC, ne do t'ju dërgojmë një kartë Fair Fares NYC OMNY Card (FFOC).
- Nëse e raportoni MetroCard-in tuaj si të humbur, të vjedhur ose të dëmtuar, FFNYC-ja do ta zëvendësojë atë me një kartë OMNY.
- Ju mund të kaloni nga MetroCard në OMNY në çdo kohë në ACCESS HRA.

Kthehuni në krye

3. A duhet ta kaloj zbritjen FFNYC në OMNY?

Po. OMNY është mënyra e re e pagesës dhe do të zëvendësojë MetroCard. Do t'ju duhet të përdorni OMNY për të udhëtuar në metrotë e NYC Transit dhe në autobusë lokalë, të kufizuar dhe të Select Bus Service (SBS), në Staten Island Railway, Roosevelt Island Tram dhe në shërbimin e autobusëve Hudson Rail Link.

4. A mund të transferoj para nga MetroCard në kartën OMNY?

Jo. Nuk mund të transferoni para nga FFM-ja në FFOC. Megjithatë, çdo gjendje në FFM-në tuaj do të jetë në dispozicionin tuaj dhe mund të përdoret për të udhëtuar në metrotë dhe autobusët lokalë, të kufizuar dhe të Select Bus Service (SBS), në Staten Island Railway, Roosevelt Island Tram dhe në shërbimin e autobusëve Hudson Rail Link.

Duhet ta përdorni gjendjen e mbetur në MetroCard para se karta të skadojë ose të anulohet. Thjesht kaloni ose futni sot MetroCard si zakonisht. Nuk mund të transferoni një gjendje nga një MetroCard me tarifë të plotë ose një kartë OMNY me tarifë të plotë në një FFM ose FFOC.

[Kthehuni në krye](#)

5. Si funksionon zbritja Fair Fares NYC?

Fair Fares NYC ju jep një zbritje 50% për tarifën për metro, autobusët e kualifikueshëm ose Access-A-Ride.

- **Metrotë dhe autobusët**

Me kartën tuaj Fair Fares NYC OMNY Card (FFOC), ju mund të udhëtoni në metro dhe në autobusët e kualifikueshëm me gjysmë çmimi!

Nëse kualifikoheni për Fair Fares NYC dhe zgjidhni zbritjen për metro ose autobus, qyteti do t'ju japë një FFOC. Karta nuk do të ketë para brenda. Nuk mund ta përdorni FFOC-në tuaj derisa të shtoni para në të.

Këto janë mënyrat se si mund të shtoni para në FFOC:

- Në një stacion të metrosë duke përdorur një makinë shitesh për kartat OMNY (mjafton të prekni kartën tuaj në ekran për të filluar).
- Në një dyqan, farmaci ose pikë të tërheqjes së parave në lagjen tuaj (vizitoni adresën omny.info/retail për të gjetur një pranë jush).
- Në internet ose me telefon me një llogari OMNY. Krijoni një llogari falas në adresën omny.info/register ose telefononi numrin 877-789-6669.

Kur shtoni para në FFOC-në tuaj dhe prekni lexuesin e kartave OMNY në autobus ose metro, do të zbritet gjysma e tarifës së momentit. Sa herë që prekni kartën tuaj, do të tarifoheni vetëm për gjysmën e çmimit aktual për një udhëtim të vetëm. Kjo kosto sa gjysma e tarifës zbritet nga gjendja juaj.

- **Access-A-Ride**

Klientët e Access-A-Ride (AAR) nuk përdorin një kartë Fair Fares OMNY. Zbritja e tyre zbatohet automatikisht! Kartat AAR shpërndahen nga (Metropolitan Transportation Authority, MTA)-ja. Nëse keni ndonjë pyetje rreth AAR-së, vizitoni faqen e tyre të internetit në adresën <https://new.mta.info/accessibility/access-a-ride> ose telefononi numrin 877-337-2017.

[Kthehuni në krye](#)

Kriteret e kualifikueshmërisë

6. Kush kualifikohet për të marrë pjesë?

Banorët e qytetit të Nju-Jorkut New York City, NYC mund të kualifikohen për Fair Fares NYC nëse:

- Janë të moshës 18 deri në 64 vjeç.
- Janë pjesë e një familjeje që përmbush udhëzimet në lidhje me të ardhurat për programin Fair Fares NYC.
- Nuk marrin tarifë transporti të plotë nga Departamenti i Shërbimeve Sociale/Administrata e Burimeve Njerëzore (Department of Social Services, DSS/Human Resources Administration, HRA) ose ndonjë agjenci tjetër e qytetit të Nju-Jorkut; dhe
- Nëse zgjedhin zbritjen Fair Fares NYC për metro dhe autobusë, nuk janë aktualisht të kualifikueshëm, ose nuk po marrin pjesë në një program tjetër për zbritje transporti.

[Kthehuni në krye](#)

7. Jam duke marrë pjesë aktualisht në programin MTA Reduced-Fare. A kualifikohem për zbritjen Fair Fares NYC?

Jo. Nëse jeni pjesë e programit MTA Reduced-Fare, ju nuk mund të përdorni zbritjen nëpërmjet programit MTA Reduced Fare në metro dhe autobusë. Nëse jeni klient i AAR-së, mund të aplikoni për zbritjen FFNYC për ta përdorur vetëm në AAR.

Mund të mësoni rreth programeve të tjera të zbritjes të MTA-së në adresën <https://mta.info/reduced-fare>.

[Kthehuni në krye](#)

8. A ndikon statusi im i imigracionit në aftësinë time për të marrë pjesë në Fair Fares NYC?

Jo. Fair Fares NYC nuk do t'ju pyesë rreth statusit tuaj të imigracionit.

[Kthehuni në krye](#)

Aplikimi për zbritjen Fair Fares NYC dhe marrja e saj

9. Si mund të aplikoj për një zbritje Fair Fares NYC?

Të gjithë banorët e qytetit të Nju-Jorkut mund të aplikojnë për një zbritje Fair Fares NYC. Vizitoni adresën nyc.gov/accessfairfares për të mësuar më tepër dhe për të aplikuar.

Mund t'ju kërkohet të jepni të dhënat tuaja personale për:

- Identitetin
- Vendbanimin dhe
- Të ardhurat

Mund t'ju duhet të dorëzoni [dokumentacionin](#). Shkoni te faqja nyc.gov/site/fairfares/faq/faq.page për të parë listën e dokumenteve të sugjeruara të Fair Fares NYC.

[Kthehuni në krye](#)

10. Si ta zbuloj nëse aplikimi im është miratuar?

Pasi ta dorëzoni aplikimin dhe të ngarkoni të gjitha dokumentet e nevojshme, prisni deri në 30 ditë që ne të shqyrtojmë aplikimin tuaj. Mund të identifikoheni në llogarinë tuaj për të kontrolluar statusin e aplikimit në adresën nyc.gov/accessfairfares. Do të njoftoheni me email pasi ta kemi shqyrtuar aplikimin tuaj.

[Kthehuni në krye](#)

11. Për sa kohë mund të marr pjesë në programin Fair Fares NYC?

Për një vit nga data e miratimit të aplikimit tuaj nëse vazhdoni të jeni të kualifikueshëm.

[Kthehuni në krye](#)

12. Kur do të pajisem me kartën Fair Fares NYC OMNY?

Pasi të miratohet aplikimi juaj, prisni 2 deri në 3 javë për dërgimin e kartës suaj Fair Fares NYC OMNY Card. Karta dërgohet me postë nëpërmjet Shërbimit Postar të Shteteve të Bashkuara (United States Postal Service, USPS). Nëse zgjedhët zbritjen Access-A-Ride, nuk do të merrni një kartë OMNY. Përkundrazi, do të merrni kartën Access-A-Ride OMNY ID nga MTA-ja.

[Kthehuni në krye](#)

13. Më është miratuar karta Fair Fares NYC OMNY Card por nuk më ka ardhur me postë. Si të veproj?

Nëse kanë kaluar më shumë se 3 javë që nga miratimi dhe nuk e keni marrë kartën Fair Fares NYC OMNY, telefononi numrin **311** ose raportoni që “nuk e keni marrë asnjëherë” kartën tuaj në [Access HRA](#).

[Kthehuni në krye](#)

14. Kam vështirësi me faqen e internetit nyc.gov/accessfairfares. Si mund të kërkoj ndihmë?

Nëse keni probleme teknike me adresën nyc.gov/accessfairfares, dërgoni email në adresën AccessHRAhelpdesk@hra.nyc.gov ose telefononi numrin **311** për ndihmë.

[Kthehuni në krye](#)

15. Më duhet ndihmë për të plotësuar aplikimin e Fair Fares NYC. Kush mund të më ndihmojë?

Vizitoni një nga pikat e Fair Fares NYC dhe personeli do t'ju ndihmojë me aplikimin tuaj. Vizitoni adresën nyc.gov/fairfares dhe klikoni “[Contact Us \(Na kontakto\)](#)” për një listë të vendndodhjeve të Fair Fares NYC. Mund të telefononi edhe numrin **311** për më shumë informacion.

[Kthehuni në krye](#)

16. Unë e marr postën në një kuti postare. Si mund ta marr kartën Fair Fares OMNY?

Nëse aplikimi ose rinovimi juaj është miratuar, ne do t'ju dërgojmë me postë kartën Fair Fares NYC OMNY në një kuti postare brenda pesë zonave të qytetit të Nju-Jorkut.

[Kthehuni në krye](#)

17. Si ta përditësoj adresën time postare?

Vizitoni adresën nyc.gov/accessfairfares për të përditësuar adresën tuaj postare.

[Kthehuni në krye](#)

18. Më është refuzuar aplikimi për Fair Fares. Si mund të marr më shumë informacion?

Aplikimi juaj mund të refuzohet nëse nuk i përmbushni kërkesat e kualifikueshmërisë. Mund të vizitoni nyc.gov/accessfairfares për të parë arsyen e refuzimit.

Njoftimi që morët shpjegon arsyen se përse nuk kualifikoheni për Fair Fares NYC. Nëse mendoni se kemi bërë një gabim, vizitoni Fair Fares NYC [në një nga zyrat e saj](#), ose telefononi **311** për të kërkuar një rishikim të aplikimit tuaj.

[Kthehuni në krye](#)

Si të dorëzoni dokumentet e aplikimit dhe pyetje të tjera të ngjashme

19. Çfarë dokumentesh do të më duhen për të verifikuar moshën, vendbanimin në qytetin e Nju-Jorkut dhe të ardhurat e mia?

Shqyrtoni listën e dokumenteve të sugjeruara të Fair Fares NYC në faqen nyc.gov/site/fairfares/faq/faq.page

[Kthehuni në krye](#)

20. Si t'i dorëzoj dokumentet për aplikimin tim?

Përdorni aplikacionin celular të ACCESS HRA për të ngarkuar dokumentet për Fair Fares NYC. Vizitoni nyc.gov/ffdocs për të shkarkuar aplikacionin ACCESS HRA, për t'u identifikuar në llogarinë tuaj, si dhe për të dorëzuar dokumentet tuaja. Nëse nuk mund ta përdorni aplikacionin celular, mund të paraqiteni në njërin nga vendndodhjet [e zyrove](#) të Fair Fares NYC për të marrë ndihmë.

[Kthehuni në krye](#)

21. U përpoqa t'i dorëzoja dokumentet, por nuk funksionoi. Si mund të kërkoj ndihmë?

Provoni të dilni nga llogaria juaj dhe më pas të identifikoheni sërish në të. Mund të duhen deri në 15 minuta që dokumentet të shfaqen. Nëse ende keni vështirësi, mund të paraqiteni në njërin nga [zyrat e Fair Fares NYC](#) për të marrë ndihmë.

[Kthehuni në krye](#)

22. Si mund ta di nëse i keni marrë dokumentet e mia?

Fair Fares do t'ju dërgojë një mesazh me tekst nëse aplikimi juaj nuk është i plotë. Gjithashtu, mund të identifikoheni sërish në llogarinë tuaj në faqen nyc.gov/accessfairfares për të kontrolluar dokumentet që janë ende të nevojshme dhe afatin e dorëzimit.

[Kthehuni në krye](#)

23. A ka afat për dorëzimin e dokumenteve?

Po. Keni 10 ditë kohë për të dorëzuar dokumentet pasi të dërgoni aplikimin tuaj. Identifikohuni në llogarinë tuaj në faqen nyc.gov/accessfairfares për të kontrolluar statusin e aplikimit tuaj dhe për të parë se sa kohë ju ka mbetur për të dorëzuar dokumentet.

[Kthehuni në krye](#)

24. Çfarë ndodh nëse nuk i dorëzoj dokumentet në kohë?

Nëse nuk i marrim dokumentet tuaja në kohë, do t'ju duhet të dërgoni një aplikim të ri.

[Kthehuni në krye](#)

Përdorimi i kartës suaj Fair Fares NYC OMNY Card

25. Ku mund ta gjej numrin e kartës Fair Fares OMNY Card?

Numri 18-shifror i kartës mund të gjendet në pjesën e pasme të kartës suaj OMNY. Këtë numër duhet ta mbani shënim.

[Kthehuni në krye](#)

26. Çfarë është numri i llogarisë tranzit i kartës OMNY dhe ku mund ta gjej atë?

Numri i llogarisë tranzit është i lidhur me të gjitha aktivitetet në llogarinë tuaj OMNY. Mund t'ju duhet t'ia jepni këtë numër shërbimit të klientit të OMNY-t nëse keni nevojë për ndihmë. Mund ta gjeni numrin e llogarisë tranzit në llogarinë tuaj OMNY pasi të shtoni kartën Fair Fares në llogarinë tuaj në Access HRA, ose duke telefonuar në numrin **311**.

[Kthehuni në krye](#)

27. A mund ta përdorë kartën time Fair Fares NYC OMNY Card (FFOC) një anëtar i familjes sime ose një miku im?

Jo. FFOC-ja juaj është vetëm për përdorim personal. Nuk mund ta ndani FFOC-në tuaj me anëtarët e familjes ose me miqtë tuaj. Nuk mund ta shitni kartën ose transaksionet tek asnjë person. Nuk mund ta huazoni kartën tek asnjë person. Shkelja e këtij rregulli përbën keqpërdorim të kartës ose mashtrim dhe mund të rezultojë në një pezullim 60-ditor të FFOC-së suaj. Nëse e shkelni këtë rregull për herë të dytë, do të përjashtoheni përgjithmonë nga Fair Fares NYC Program.

[Kthehuni në krye](#)

28. A mund ta përdor kartën time Fair Fares OMNY (FFOC) në të gjitha sistemet e transportit publik të qytetit të Nju-Jorkut?

Mund ta përdorni FFOC-në tuaj në metrotë dhe në autobusët lokalë të qytetit të Nju-Jorkut, si dhe në Staten Island Railway, Roosevelt Island Tram dhe Hudson Rail Link dhe do të tarifoheni gjysmën e tarifës.

Kur OMNY të bëhet e disponueshme në autobusët e Westchester Bee-Line dhe të Nassau Inter-County Express (NICE), atëherë do të mund ta përdorni FFOC-në tuaj në ato shërbime, me gjysmë tarife. Megjithatë, kini parasysh se, edhe pse ju mund ta përdorni FFOC-në për të paguar gjithashtu për udhëtimin në një autobus ekspres në Long Island Railroad, Metro-North Railroad, PATH dhe JFK AirTrain, do të tarifoheni me tarifën e plotë.

[Kthehuni në krye](#)

29. Si të shtoj para në kartën time Fair Fares NYC OMNY Card (FFOC)?

Po ju paraqesim mënyrat se si mund t'i shtoni para FFOC-së suaj sapo ta merrni:

- Në një makinë për kartat OMNY që ndodhet në stacionet e metrosë së NYC Transit.
- Në dyqanet pjesëmarrëse në të gjithë qytetin. Për vendndodhjen e dyqaneve OMNY, vizitoni faqen <https://omny.info/retail-locations>.
- Duke telefonuar shërbimin e klientit të OMNY në numrin **877-789-6669**.
- Në internet nëpërmjet llogarisë së regjistruar në OMNY (<https://omny.info/register>). Gjithashtu, mund të caktoni rimbushje automatike përmes një llogarie OMNY, kështu që nuk do të shqetësoheni më për një bilanc të ulët.

30. A e marr tarifën maksimale bashkë me kartën Fair Fares NYC OMNY Card (FFOC)?

Po. Nëse bëni 12 udhëtime me pagesë brenda një periudhe 7-ditore duke përdorur të njëjtën FFOC, pjesa e mbetur e udhëtimeve të së njëjtës javë do të jetë automatikisht pa pagesë. Duhet ta përdorni FFOC-në tuaj për çdo udhëtim individual me pagesë. Gjithashtu duhet ta përdorni kartën tuaj kur transferoheni, por kjo nuk llogaritet si një nga 12 udhëtimet me pagesë pasi transferimi është pa pagesë.

[Kthehuni në krye](#)

31. A duhet të krijoj një llogari OMNY?

Po. Ndonëse është opsionale, një llogari OMNY është e sigurt dhe ju lejon:

- të gjurmoni ecurinë tuaj drejt arritjes së tarifës maksimale për 7 ditë,
- të rimbushni kartën tuaj,
- të menaxhoni mënyrën e pagesës,
- të merrni njoftime nga llogaria,
- ta ngrini menjëherë kartën tuaj në rast se ju humb ose nëse jua vjedhin,
- si dhe më shumë!

Për t'u regjistruar në një llogari OMNY, vizitoni faqen <https://omny.info/register>.

Nëse ju duhet ndihmë për t'u regjistruar në një llogari OMNY, kontaktoni shërbimin e klientit të OMNY duke telefonuar **877-789-6669**.

[Kthehuni në krye](#)

32. Çfarë duhet të bëj nëse më është tarifuar tarifa e plotë dhe jo tarifa e zbritur?

Kontrolloni llogarinë tuaj Access HRA për të parë nëse ende figuroni të regjistruar në program. Nëse ende jeni të regjistruar, telefononi **311** për të marrë ndihmë.

[Kthehuni në krye](#)

33. Kë duhet të telefonoj nëse kam një pyetje rreth një tarifimi në kartën time OMNY (e ndryshme nga tarifa e plotë)?

Kontaktoni shërbimin e klientit të OMNY duke telefonuar në numrin **877-789-6669**.

[Kthehuni në krye](#)

Humbja e kualifikueshmërisë

34. Kam marrë njoftimin se regjistrimi im po ndërpritet për shkak se nuk kualifikohem më. Mendoj se ka ndodhur një gabim. Me kë mund të flas?

Mund ta humbisni kualifikueshmërinë tuaj nëse nuk i përmbushni më kërkesat e kualifikueshmërisë. Mund të vizitoni nyc.gov/accessfairfares për të parë arsyen se përse nuk jeni më të kualifikuar.

Njoftimi që morët shpjegon arsyen se përse nuk kualifikoheni për Fair Fares NYC dhe datën e përfundimit të zbritjes suaj. Pas kësaj date, çdo udhëtim i bërë me FFOC-në tuaj do të tarifohet me tarifa të plotë.

Nëse mendoni se kemi bërë një gabim, vizitoni Fair Fares NYC [në njërin nga zyrat](#) e saj, ose telefononi **311** për të kërkuar një rishikim të aplikimit tuaj.

[Kthehuni në krye](#)

35. Sa kohë kam për të bërë kërkesë për rishikimin e përcaktimit të kualifikueshmërisë sime?

Duhet të kërkonti një rishikim brenda 14 ditëve nga marrja e njoftimit për ndërprerjen e regjistrimit tuaj. Nëse nuk na kontaktoni, zbritja juaj do të përfundojë në datën e treguar në njoftimin tuaj.

[Kthehuni në krye](#)

36. Çfarë ndodh nëse marr njoftimin se zbritja Fair Fares NYC do të ndërpritet për shkak të keqpërdorimit ose veprimtarisë së paautorizuar?

Në momentin që konstatohen keqpërdorime ose veprimtari të paautorizuara, zbritja juaj për Fair Fares NYC do të pezullohet. Nëse keni një kartë Fair Fares NYC OMNY Card, ajo do të rikthehet në tarifë të plotë. Do ta humbisni kualifikueshmërinë tuaj për Fair Fares NYC dhe nuk do të keni mundësi të merrni pjesë për 60 ditë në Fair Fares NYC. Duhet të riaplikoni pasi të kalojnë 60 ditë, si dhe duhet të pranoheni si të kualifikuar për të marrë sërish zbritjen Fair Fares NYC.

Kur konstatohen shkelje për herë të dytë për shkak të keqpërdorimit ose veprimtarisë së paautorizuar, do të përjashtoheni përgjithmonë nga pjesëmarrja në program dhe zbritja juaj do të ndërpritet. Mund të telefononi **311** nëse keni pyetje.

[Kthehuni në krye](#)

Karta të humbura, të vjedhura, ose të dëmtuara

37. Sa herë mund ta zëvendësoj kartën time të humbur ose të vjedhur Fair Fares NYC OMNY?

Fair Fares NYC do t'i zëvendësojë vetëm kartat e humbura, të vjedhura, ose të dëmtuara një herë për çdo vit regjistrimi.

38. Si të veproj nëse karta Fair Fares NYC OMNY më ka humbur, më është vjedhur ose dëmtuar?

Identifikohuni në llogarinë tuaj Fair Fares në faqen nyc.gov/accessfairfares dhe klikoni "Report FFNYC OMNY card Lost, Stolen or Damaged (Raporto kartën FFNYC OMNY si të humbur, vjedhur ose të dëmtuar)". Ndiqni udhëzimet në ekran.

Gjithashtu mund të telefononi **311**. Pasi të merret raporti juaj, do të merrni një kartë të re Fair Fares NYC OMNY në postë brenda 2 deri në 3 javëve, për sa kohë që jeni ende të kualifikuar.

Nëse e keni raportuar fillimisht kartën tuaj tek OMNY në llogarinë tuaj OMNY ose përmes telefonit, duhet ta raportoni përsëri kartën tuaj te Fair Fares për ta zëvendësuar.

[Kthehuni në krye](#)

39. Si ta kaloj gjendjen e mbetur në kartën time të re?

Mund ta transferoni gjendjen tuaj nga karta e humbur, vjedhur, ose e dëmtuar në kartën tuaj të re Fair Fares NYC OMNY Card duke telefonuar shërbimin e klientit të OMNY-t në numrin **877-789-6669**. Duhet të dërgoni adresën e emailit të lidhur me llogarinë tuaj OMNY. Nëse nuk keni një llogari OMNY, duhet të jepni numrin e kartës ose numrin e llogarisë tranzit për kartën OMNY të humbur. Mund ta gjeni numrin e llogarisë tranzit në llogarinë tuaj të Access HRA ose duke telefonuar **311**.

Nuk ka rimbursime për kartat OMNY të humbura ose të vjedhura. Vetëm transfertat e gjendjes.

[Kthehuni në krye](#)

Rinovimet

40. Sa shpesh duhet ta rinovoj regjistrimin tim në Fair Fares NYC?

Duhet ta rinovoni regjistrimin tuaj në Fair Fares NYC një herë në vit. Duhet të kualifikoheni për programin gjatë asaj kohe në mënyrë që t'ju rinovohet zbritja juaj Fair Fares NYC.

[Kthehuni në krye](#)

41. Si mund ta rinovoj regjistrimin tim në Fair Fares NYC?

Identifikohuni në llogarinë tuaj në faqen nyc.gov/accessfairfares për të rinovuar regjistrimin tuaj në Fair Fares NYC, pasi të merrni një njoftim për rinovim nga Fair Fares. Bëjeni këtë të paktën 30 ditë përpara përfundimit të regjistrimit tuaj për të shmangur boshllëqet në zbritjen tuaj.

[Kthehuni në krye](#)

42. A do të njoftohem kur duhet të bëj rinovim?

Po. Do t'ju dërgojmë një njoftim me postë dhe me mesazh kur të vijë koha për të rinovuar. Do të përdorim adresën postare që keni dhënë te Fair Fares NYC. Mund të kontrolloni faqen kryesore të Fair Fares NYC për përditësimet dhe afatet në çdo kohë.

[Kthehuni në krye](#)

43. A ka një afat për rinovimin?

Po. Njoftimi i rinovimit do të tregojë afatin tuaj për të rinovuar. Nëse nuk rinovoni brenda afatit, duhet të dërgoni një aplikim të ri. Kontrolloni llogarinë tuaj Fair Fares NYC për informacion rreth regjistrimit tuaj.

[Kthehuni në krye](#)

44. Çfarë ndodh nëse nuk e arrij afatin e rinovimit?

Nëse e humbisni afatin e rinovimit, do t'ju duhet të dërgoni një aplikim të ri. Kjo do të shkaktojë një pezullim të përkohshëm të zbritjes suaj. Ndërkohë që llogaria juaj pezullohet përkohësisht, karta juaj Fair Fares OMNY Card do të tarifohet me tarifën e plotë nëse udhëtoni me të. Zbritja juaj do të rifillojë pasi të rinovoni ose të riaplikoni dhe pasi të miratohet aplikimi juaj.

[Kthehuni në krye](#)

45. Si mund ta di nëse kualifikohem ende për Fair Fares NYC?

Vizitoni nyc.gov/fairfares për të kontrolluar kualifikueshmërinë tuaj. Për të rinovuar regjistrimin tuaj në programin Fair Fares NYC, duhet të vazhdoni t'i plotësoni kërkesat e kualifikueshmërisë për Fair Fares NYC.

[Kthehuni në krye](#)

46. Si ta përditësoj adresën time, ose çdo informacion tjetër që ka ndryshuar vitin e kaluar?

Mund ta përditësoni adresën postare në internet në çdo kohë përmes llogarisë tuaj në internet. Mund t'i përditësoni informacionet e tjera të profilit kur ta dërgoni kërkesën tuaj për rinovim në nyc.gov/fairfares. Mund të telefononi **311** për të përditësuar adresën tuaj postare.

[Kthehuni në krye](#)

47. Po nëse adresa ime e re nuk është në qytetin e Nju-Jorkut?

Vetëm banorët e qytetit të Nju-Jorkut kualifikohen për Fair Fares NYC.

[Kthehuni në krye](#)

48. Çfarë dokumentesh duhet të dorëzoj bashkë me aplikimin për rinovim?

Shqyrtoni listën e dokumenteve të sugjeruara të Fair Fares NYC në faqen nyc.gov/site/fairfares/faq/faq.page

[Kthehuni në krye](#)

49. A do të pajisem me një kartë të re Fair Fares NYC OMNY kur të bëj rinovimin?

Do të vazhdoni të përdorni Fair Fares NYC OMNY Card (FFOC) që ju është dërguar, përveç nëse karta juaj ka humbur ose është vjedhur, ose nëse asaj po i afrohet data e skadencës. FFOC-ja juaj do të jetë e vlefshme për shumë vite.

[Kthehuni në krye](#)

50. A do të jem në gjendje të vazhdoj ta përdor zbritjen aktuale Fair Fares NYC pasi të miratohet aplikimi im për rinovim?

Po. Do të mund të vazhdoni ta përdorni zbritjen tuaj aktuale Fair Fares NYC deri sa të skadojë regjistrimi juaj (kur nuk kualifikoheni më). Edhe kur regjistrimi juaj të skadojë, mund të vazhdoni ta përdorni kartën tuaj OMNY për të paguar tarifën e plotë.

[Kthehuni në krye](#)

Kartat e skaduara

51. Si mund ta kuptoj se kur është afër skadencës karta ime Fair Fares NYC OMNY?

Data e skadimit ndodhet në pjesën e pasme të kartës suaj.

[Kthehuni në krye](#)

52. Çfarë ndodh nëse karta ime Fair Fares NYC OMNY Card (FFOC) do të skadojë në më pak se 30 ditë?

Karta juaj FFOC ka një afat më të gjatë skadence dhe do të jetë e vlefshme për shumë vite. Duhet të vazhdoni ta përdorni kartën tuaj derisa ajo të skadojë. Nëse jeni ende të regjistruar në program dhe karta juaj aktuale FFOC do të skadojë së shpejti, FFNYC-ja do t'ju dërgojë automatikisht me postë një kartë të re afërsisht 30 ditë para skadimit të kartës suaj aktuale. Kur të merrni kartën tuaj zëvendësuese FFOC, mund ta transferoni gjendjen nga karta juaj e skaduar në kartën tuaj të re FFOC duke kontaktuar shërbimin e klientit të OMNY-t në **877-789-6669**.

[Kthehuni në krye](#)

53. A mund të përdor një Fair Fares OMNY Card (FFOC) të skaduar nëse ka ende para brenda?

Jo. FFOC-ja juaj nuk do të funksionojë pas datës së skadimit. Kur karta juaj të skadojë, mund ta transferoni gjendjen në kartën e re duke kontaktuar shërbimin e klientit të OMNY-t në numrin **877-789-6669**.

[Kthehuni në krye](#)

Telefononi 311 nëse keni ndonjë pyetje për programin Fair Fares NYC. Gjithashtu mund të vizitoni nyc.gov/fairfares për më shumë informacion në lidhje me programin Fair Fares NYC.